VENDIM
Nr. 141, datë 16.7.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "BMG ENERGY SAL" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1569/1 prot., datë 10.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'BMG Energy SAL' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "BMG Energy SAL" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1569 prot., datë 1.7 2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 të Rregullores për pikën 1.1, germat "a" "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "c" dhe "d"; për pikën 1.3 germën "c"; për pikën 2.1 germat "b", "c", "d", dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "BMG Energy SAL" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kontratën nr. 3247 rep., nr. 2138 kol., datë 2.6.2023, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "BMG Energy SAL" sh.p.k.";

- Ka nënshkruar me shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" marrëveshjen nr. 9511/2 prot., datë 13.10.2023, për lidhjen e centralit fotovoltaik të shoqërisë "BMG Energy SAL" sh.p.k. me rrjetin e shpërndarjes.

- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Pika 1, "Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë"

Pika 1.2

- Germa "b": Vërtetimi për vetë shoqërinë duhet të depozitohet me datë të përditësuar dhe i lëshuar jo më vonë se 1 muaj nga paraqitja e aplikimit.

Pika 1.3

- Germa "a": Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin përkatës që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Germa "b": Shoqëria duhet të saktësojë/sqarojë ndryshimet e mënyrës së financimit të projektit, si dhe të depozitojë vendimet përkatëse të organeve drejtuese të saj dhe të ortakut të vetëm të saj në lidhje me financimin e projektit.

Pika 2, "Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës"

Pika 2.1

- Germa "a": Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse në numrin e njësive gjeneruese dhe kapacitetin e instaluar të secilës, të depozitojë dokumentacionin teknik në lidhje me jetëgjatësinë e centralit fotovoltaik, si dhe të përcaktojë një datë konkrete për operimin e centralit.

- Germa "e": Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentin përkatës të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), VNM paraprake, deklaratë mjedisore etj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "BMG Energy SAL" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "BMG Energy SAL" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti